



Në bazë të nenit 64 paragrafi (1) dhe (2) nga (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16 и 11/18), Ministria e Kulturës shpall:

KONKURS
për mbështetjen e përsosjes profesionale të kuadrove deficitare të arteve dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nga fusha e kulturës për vitin 2022

I. INFORMATAT E PËRGJITHSHME

Ministria e Kulturës për mbështetje të përsosjes profesionale të kuadrove deficitare në fushën e kulturës për vitin 2022, do të sigurojë mjete në shumë të njohura nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 për:

1. Studime të ciklit të parë në institucione të arsimit të lartë dhe akademitë jashtë vendit në fushën e: artit të baletit, artit muzikor, artet vizuale, artit dramatik, bibliotekonomi dhe dokumentim dhe konservimi dhe restaurimi i trashëgimisë kulturore.
2. Studime të ciklit të dytë dhe të tretë në institucione të arsimit të lartë dhe akademitë jashtë vendit në fushën e: arteve vizuale, artit muzikor, artit të baletit, artit dramatik, bibliotekonomi dhe dokumentim dhe konservimi dhe restaurimi i trashëgimisë kulturore.
3. Qëndrim profesional tek profesorët dhe mentorët, gjegjësisht qëndrime të shkurta në universitete dhe akademi jashtë vendit, dhe specializime tek artistët me famë botërore – profesorë jashtë vendit nga fusha e: teatrit, muzikës, vallëzimit, letërsisë, arteve vizuale, arkitekturës dhe dizajnit.
4. Qëndrim profesional, gjegjësisht qëndrime të shkurta në universitete dhe akademi jashtë vendit, dhe specializime në institucione të njohura shkencore, arsimore dhe profesionale nga fusha e mbrojtjes, konservimit dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore (të paluajtshme, të luajtshme dhe jomateriale) jashtë vendit.

II. KUSHTET E PJESËMARRJES NË KONKURS

Të drejtë pjesëmarrje në Konkurs për mbështetjen e përsosjes profesionale të kuadrove deficitare në fushën e kulturës për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm : Konkursi) kanë:

1. Personat fizikë që janë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
2. Persona të cilët janë të regjistruar në ciklin e parë të studimeve në institucione të arsimit të lartë dhe akademitë jashtë vendit në fushën e: artit të baletit, artit muzikor, artet vizuale, artit dramatik, bibliotekonomi dhe dokumentim dhe konservim dhe restaurim të trashëgimisë kulturore.
3. Persona të cilët janë të regjistruar në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve në institucione të arsimit të lartë dhe akademitë jashtë vendit në fushën e: arteve vizuale, artit muzikor, artit të baletit, artit dramatik, bibliotekonomi dhe dokumentim dhe konservim dhe restaurim të trashëgimisë kulturore.



4. Të mos jenë më të moshuar se 27 vjet për studimet e ciklit të parë, gjegjësisht nga mosha 30 vjeçare për studimet e ciklit të dytë, gjegjësisht nga mosha 35 vjeçare për studimet e ciklit të tretë.
5. Të posedojnë një rekomandim dhe letër me mbështetje nga profesori ose mentori (për kandidatët të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për qëndrim profesional tek profesori ose mentori, gjegjësisht për qëndrime të shkurta në universitete dhe akademi jashtë vendit, dhe për specializime tek artistët me famë botërore – profesorë jashtë vendit nga fusha e:teatrit, muzikës, vallëzimit, letërsisë, arteve vizuale, arkitekturës dhe dizajnit).
6. Të posedojnë një rekomandim dhe letër me mbështetje nga profesori ose konservator i autorizuar (për kandidatët të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për qëndrim profesional tek profesori ose mentori, gjegjësisht për qëndrime të shkurta në universitete dhe akademi jashtë vendit, dhe për specializime në institucione të njohura shkencore, arsimore dhe profesionale nga fusha e mbrojtjes, konservimit dhe resaurimit të trashëgimisë kulturore jashtë vendit).

III. KRITERET

Që të mund të mbështetet në Konkurs, kandidati duhet ti përmbush kriteret e mëposhtme:

1. Të ketë të përfunduar arsimin e mesëm me notë mesatare të paktën 4,5 (për kandidatët të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për studime post diplomike nga fusha e artit të baletit, artit muzikor, artet vizuale, artit dramatik, bibliotekonomi dhe dokumentim dhe konservim dhe restaurim të trashëgimisë kulturore).
2. Të ketë të mbaruar ciklin e parë, gjegjësisht ciklin e parë dhe të dytë të studimeve me sukses mesatar të paktën 8,5 (për kandidatët të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për studime post diplomike dhe studime të doktoraturës nga fusha e: arteve vizuale, artit muzikor, artit të baletit, artit dramatik, bibliotekonomi dhe dokumentim dhe konservim dhe restaurim të trashëgimisë kulturore.
3. Të ketë marrë pjesë në realizimin e të paktën dy projekteve nga fusha e: teatrit, muzikës, vallëzimit, letërsisë, arteve vizuale, arkitekturës dhe dizajnit, mbrojtjes, konservimit dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore (të paluajtshme, të luajtshme dhe jomateriale),(për kandidatët të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për qëndrim profesional tek profesori ose mentori, gjegjësisht për qëndrime të shkurta në universitete dhe akademi jashtë vendit, dhe për specializime tek artistët me famë botërore – profesorë jashtë vendit nga fusha e: teatrit, muzikës, vallëzimit, letërsisë, arteve vizuale, arkitekturës dhe dizajnit, dhe për kandidat të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për qëndrim profesional tek profesori ose mentori, gjegjësisht për qëndrime të shkurta në universitete dhe akademi jashtë vendit, dhe për specializime në institucione të njohura shkencore, arsimore dhe profesionale nga fusha e mbrojtjes, konservimit dhe resaurimit të trashëgimisë kulturore (të paluajtshme, të luajtshme dhe jomateriale) jashtë vendit.

IV. VLERAT NË BAZË TË SË CILAVE FLETËPARAQITJET DO TË VLERËSOHEN

1. Për kandidatët të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për ciklin e parë të studimeve nga fusha e artit të baletit, artit muzikor, arteve vizuale, artit dramatik, bibliotekonomi dhe dokumentim dhe konservim dhe restaurim të trashëgimisë kulturore:
 - sukses të aritur në arsimin e mesëm prej 21 deri në 80 pikë, dhe atë:



- .prej 4,5 deri në 4,6 - 51 pikë
- .prej 4,6 deri në 4,7 – 58 pikë
- .prej 4,7 deri në 4,8 – 65 pikë
- .prej 4,8 deri në 4,9 – 72 pikë dhe
- .prej 4,9 deri në 5,0 – 80 pikë

dhe

- çmime të fituara në gara ndërkombëtare dhe vendore deri në 20 pikë, dhe atë:

- .për fitues të vendit të tretë në garat vendore – 1 pikë,
- .për fitues të vendit të dytë në garat vendore – 3 pikë
- .për fitues të vendit të parë në garat vendore -5 pikë ose
- .për fitues të vendit të tretë në garat jashtë vendit – 5 pikë
- .për fitues të vendit të dytë në garat jashtë vendit – 10 pikë
- .për fitues të vendit të parë në garat jashtë vendit – 20 pikë.

2. Për kandidatët të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për ciklin e dytë dhe të tretë nga fusha e: arteve vizuale, artit muzikor, artit të baletit, artit dramatik, bibliotekonomi dhe dokumentim dhe konservim dhe restaurim të trashëgimisë kulturore:

-sukses të aritur për përfundim të ciklit të parë, gjegjësisht ciklit të parë dhe të dytë të studimeve akademike universitare prej 51 deri në 80 pikë, dhe atë:

- . nga 8,5 deri në 9,0 – prej 51 deri në 60 pikë
- . nga 9,0 deri në 9,5 – prej 61 deri në 70 pikë
- . nga 9,5 deri në 10,0 – prej 71 deri në 80 pikë

dhe

- pjesëmarrje në projekte, punëtori dhe projekte hulumtuese që synojnë zhvillimin e segmenteve të caktuara të artit deri në 20 pikë (për kandidatët të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për studime post diplomike dhe studime të doktoraturës nga fusha e: arteve vizuale, arkitektura dhe dizajni, artit muzikor, artit të baletit dhe artit dramatik), gjegjësisht punime të botuara në revista vendase ose të huaja nga fusha përkatëse më së shumti deri në 20 pikë, dhe atë: në revistë vendase 10 pikë, ndërsa në revistë të huaj 20 pikë (për kandidatët të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për studime post diplomike dhe për studime të doktoraturës për konservim dhe restaurim të trashëgimisë kulturore).

3. Për kandidatët të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për qëndrim profesional tek profesorët dhe mentorët jashtë vendit, gjegjësisht qëndrime të shkurta në universitete dhe akademitë jashtë vendit, ose për specializime tek artistët me famë botërore nga fusha e teatrit, muzikës, vallëzimit, letërsisë, arteve vizuale, arkitekturës dhe dizajnit dhe për kandidatë të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për qëndrim profesional tek profesorët ose mentorët jashtë vendit, gjegjësisht qëndrime të shkurta në universitete dhe akademitë jashtë vendit dhe për specializime në institucione të njohura shkencore, arsimore dhe profesionale nga fusha e mbrojtjes, konservimit dhe resaurimit të trashëgimisë kulturore (të paluajtshme, të luajtshme dhe jomateriale) jashtë vendit.

- . pjesëmarrje në realizimin e të paktën dy projekteve (51 pikë)
- . pjesëmarrje në realizimin e të paktën dy deri në katër projekte (52 – 80 pikë)
- . pjesëmarrje në realizimin e më shumë se katër projekte (81 – 100 pikë).

V. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM



1. Kandidatët e regjistruar në ciklin e parë të studimeve në institucione të arsimit të lartë dhe akademitë jashtë vendit në fushën e: artit të baletit, artit muzikor, artet vizuale, artit dramatik, bibliotekonomi dhe dokumentim dhe konservim dhe restaurim të trashëgimisë kulturore, duhet ti dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- . Vërtetim për regjistrim me përkthim në gjuhë maqedonase nga përkthyesi i autorizuar gjyqësor.
- . Dëftesa (nga viti i parë deri në të vit të katërt) dhe diplomë për arsimit të mesëm të përfunduar (kopje e verifikuar në noter).
- . Dëshmi për çmime të fituara.
- . Kopje e Shtetësisë së Republikës së Maqedonisë.

2. Kandidatët e regjistruar në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve në institucione të arsimit të lartë dhe akademitë jashtë vendit në fushën e: arteve vizuale, artit muzikor, artit të baletit, artit dramatik, bibliotekonomi dhe dokumentim dhe konservim dhe restaurim të trashëgimisë kulturore, duhet ti dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- . Vërtetim për regjistrim me përkthim në gjuhë maqedonase nga përkthyesi i autorizuar gjyqësor.
- . Dëshmi për suksesin e arritur gjatë viteve të fundit.
- . Dëshmi për pjesëmarrje në punëtori dhe projekte hulumtuese, gjegjësisht dëshmi për punime të botuara.
- . Kopje e Shtetësisë së Republikës së Maqedonisë

3. Kandidatët të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për qëndrim profesional tek profesorët dhe mentorët jashtë vendit, gjegjësisht qëndrime të shkurta në universitete dhe akademitë jashtë vendit, ose për specializime tek artistët me famë botërore – profesorë jashtë vendit nga fusha e: teatrit, muzikës, vallëzimit, letërsisë, arteve vizuale, arkitekturës dhe dizajnit, dhe kandidatë të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për qëndrim profesional tek profesorët dhe mentorët jashtë vendit, gjegjësisht qëndrime të shkurta në universitete dhe akademitë jashtë vendit dhe për specializime në institucione të njohura shkencore, arsimore dhe profesionale nga fusha e mbrojtjes, konservimit dhe resaurimit të trashëgimisë kulturore (të paluajtshme, të luajtshme dhe jomateriale) jashtë vendit, duhet ti dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- . Rekomandim dhe shkresë me mbështetje nga profesori / mentori/ konservator i autorizuar
- . Dëshmi se ka qenë pjesëmarrës në projekte.
- . Kopje e Shtetësisë së Republikës së Maqedonisë.

VI. MËNYRA E FINANCIMIT

1. Që të mund të marrin mbështetje kandidatët të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për ciklin e parë të studimeve nga fusha e: artit të baletit, artit muzikor, arteve vizuale, artit dramatik, bibliotekonomi dhe dokumentim dhe konservim dhe restaurim të trashëgimisë kulturore, duhet të fitojnë së paku 52 pikë.
2. Që të mund të marrin mbështetje kandidatët të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për ciklin e dytë



dhe të tretë të studimeve nga fusha e:artëve vizuale, artit muzikor, artit të baletit, artit dramatik, bibliotekonomi dhe dokumentim dhe konservim dhe restaurim të trashëgimisë kulturore, duhet të fitojnë së paku 51 pikë.

3. Që të mund të marrin mbështetje kandidatët të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për qëndrim profesional tek profesorët dhe mentorët jashtë vendit, gjegjësisht për qëndrime të shkurta në universitete dhe akademitë jashtë vendit ose për specializim tek artistët me famë botërore – profesorë jashtë vendit nga fusha e: teatrit, muzikës, vallëzimit, letërsisë, arteve vizuale, arkitekturës dhe dizajnit, dhe kandidatët të cilët dorëzojnë fletëparaqitje për qëndrim profesional tek profesorët dhe mentorët jashtë vendit, gjegjësisht qëndrime të shkurta në universitete dhe akademitë jashtë vendit dhe për specializime në institucione të njohura shkencore, arsimore dhe profesionale nga fusha e mbrojtjes, konservimit dhe resaurimit të trashëgimisë kulturore (të paluajtshme, të luajtshme dhe jomateriale) jashtë vendit, duhet të fitojnë së paku 51 pikë.

Vlera e mbështetjes finaciare është e dhënë në Bashkangjitjen 1 dhe është pjesë përbërëse e këtij Konkursi.

VI. MËNYRA E APLIKIMIT DHE AFATI I DORËZIMIT TË FLETËPARAQITJEVE

Fletëparaqitja, e cila është pjesë përbërëse e Konkursit, shkarkohet nga faqja e internetit të Ministrisë së Kulturës www.kultura.gov.mk dhe plotësohet në formë elektronike me të shënuarit e të dhënave në vendin e caktuar, nënshkruhet dhe dërgohet në formë të shtypur në Ministrinë e Kulturës.

Fletëparaqitja me dokumentacionin shoqëruerdërgohet në Ministrinë e Kulturës me postë (rr. "Gjuro Gjakoviq" nr. 61, 1000 Shkup), me datën e vulës postare.

Nuk do të shqyrtohen fletëparaqitjet në vijim: të dërguara pas skadimit të afatit të Konkursit, të plotësuara në formular joadekuatë, të dërguara me postë elektronike, të plotësuara në mënyrë jo të plotë dhe fletëparaqitjet e pakompletuara pa dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar. Materialet e dërguara me fletëparaqitjet e Konkursit nuk kthehen.

Konkursi do të zgjasë deri më 31.12.2021

VIII. NJOFTIMI PËR REZULTATET E KONKURSIT

Të gjithë pjesëmarrësit në Konkurs për rezultatet do të njoftohen në pajtim me Ligjin për kulturë. Me pjesëmarrësit të cilët kanë marrë mbështetjen në Konkurs, Ministria e Kulturës do të lidhë marrëveshje individuale në të cilat do të përcaktohen kushtet dhe obligimet për shfrytëzimin e mjeteve.

IX. INFORMATAT PLOTËSUESE

Për informata plotësuese, pjesëmarrësit në Konkurs mund të drejtohen në Ministrinë e Kulturës te nënpunësi shtetëror përgjegjës për veprimtarinë përkatëse në fushën e kulturës, Besim Memishi, në numrin e telefonit **3240 595**.

MINISTRIA E KULTURËS
rr. Gjuro Gjakoviqnr. 61
1000 Shkup



Republika e Maqedonisë së Veriut
www.kultura.gov.mk

